



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE
Kryesia

Nr. 437 Prot.

Tiranë, më 07.3.2025

Vendim nr. 15 datë 07.03.2025

**Për rikrijimin e njësisë kërkimore të përkohshme
të gjeoshkencave dhe gjeoinxhinierive**

Referuar nenit 4 pika 6 dhe nenit 19 pikat 1 dhe 3 të Ligjit 53/2019 *Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë*;

Mbështetur në nenet 43 - 44 të Statutit të Akademisë së Shkencave;

Pas shqyrtimit të kërkesës së drejtuesit të njësisë kërkimore të gjeoshkencave dhe gjeoinxhinierive, për zgjatje të mandatit 2-vjeçar dhe ndryshime në përbërjen e anëtarësisë së njësisë, si dhe njohjes me raportin e veprimtarisë së njësisë për periudhën mars 2023-shkurt 2024 dhe propozimet për veprimtarinë kërkimore-shkencore për vitet 2025-2027, në shkresën me nr. prot. 282, datë 20.2.2025 (bashkëlidhur); konsultimit me komisionin e përhershëm të inxhinierisë dhe miratimin nga anëtarët e Seksionit të Shkencave Natyrore e Teknike (bashkëlidhur);

Kryesia e Akademisë së Shkencave, në mbledhjen e datës .3.2025;

VENDOSI:

1. Të ringrejë njësinë kërkimore të përkohshme të gjeoshkencave dhe gjeoinxhinierive, e cila deri më datë 1.03.2025, ka vepruar sipas vendimit nr. 10, datë 1.03.2023 të Kryesisë, edhe për dy vjet të tjera.
2. Propozimet e paraqitura, nga akad. asoc. Rrapo Ormëni, drejtues i njësisë, për veprimtarinë e saj (bashkëngjitur), programuar edhe në programin vjetor të ASH-së, miratuar me vendimin e Asamblesë, nr. 12, datë 28.02.2025, të shërbejë në dy vitet në vijim.

3. Përbërja e njësisë të jetë: akad. asoc. Rrapo Ormëni, drejtues i njësisë; prof. Naser Peçi, Prof. Ismail Hoxha, dr. Markel Baballëku, dr. Adrian Bylyku, dr. Albana Hasimi, anëtarë dhe dr. Arben Pambuku, koordinator.

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen: sekretari shkencor, kryetari i SSHNT, drejtuesi i njësisë, kancelari, sektori i buxhetit dhe i finances dhe specialistja e burimeve njerëzore dhe juriste.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Akademik Skënder GJINUSHI

KRYETAR

